

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – PUNË NR. 1

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

“Rikonstruktion, Përforcim i Godinës së Obstetrikës, Rikonstruktion dhe termoizolim i fasadës së Godinës së Gjinekologjisë dhe sistemimet e jashtme brenda Kompleksit të Godinave të Spitalit Obstetrik Gjinekologjik Mbretëresha Geraldinë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

45000000-7 – Punime ndërtimi.

LLOJI I PROCEDURËS:

Procedurë e hapur elektronike - Pune.

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit i kontratës: **237,852,663** (dyqind e tridhjetë e shtatë milion e tetëqind e pesëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre) **lekë pa TVSH**, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit.

Fondi për vitin 2023 (deri në muajin Mars) është 57,084,639.00 (pesëdhjetë e shtatë milion e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë) lekë pa TVSH. Diferenca do të likuidohet në muajt/vitet në vazhdim.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është: 4,757,053.26 (katër milion e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë e tre, pikë njëzet e gjashtë) Lekë pa TVSH për një periudhë vlefshmërie prej 180 ditë.

Më datë 12.04.2023, Njësia e Prokurimit i kërkoi APP-së (përmes sistemit e-procurement) asistencë në lidhje me draftin e përgatitur të DST për procedurën e prokurimit me objekt: “Rikonstruktion, Përforcim i Godinës së Obstetrikës, Rikonstruktion dhe termoizolim i fasadës së Godinës së Gjinekologjisë dhe sistemimet e jashtme brenda Kompleksit të Godinave të Spitalit Obstetrik Gjinekologjik Mbretëresha Geraldinë” të parashikuar në Regjistër për vitin 2023, duke u shprehur:

“Të nderuar,

SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë” ka planifikuar në Regjistrin e Prokurimeve, realizimin mundësisht në muajin Prill të vitit 2023, të procedurës së prokurimit me objekt: “Rikonstruktion, Përforcim i Godinës së Obstetrikës, Rikonstruktion dhe termoizolim i fasadës së Godinës së Gjinekologjisë dhe sistemimet e jashtme brenda Kompleksit të Godinave të Spitalit Obstetrik Gjinekologjik Mbretëresha Geraldinë”.”

Një procedurë e tillë prokurimi po zhvillohet për herë të parë nga SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë” pasi më përpara procedura të tilla janë zhvilluar nga Ministria e Shëndetësisë. Për këtë arsye SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë” e vlerëson si të domosdoshme ndihmën/asistencën që APP mund të japë në këtë fazë të procedurës në lidhje me DST dhe sidomos kriteret e veçanta të kualifikimit.

Duke kërkuar mendimin dhe sugjerimet e APP-së në lidhje me cdo detaj të DST, theksojmë që përsa i përket licencës profesionale që OE duhet të paraqesë në lidhje me objektet e trashëgimisë kulturore, në pikën 2.2.3 të DST kemi parashikuar dy licenca N-Z/A/4 dhe N-Z/A/6 por mbetemi të paqartë nëse këto licenca jepen dhe duhet ti kërkohej subjekteve juridike, pra OE apo BOE, apo këto licenca lidhen me subjektet fizike (Individët) e punësuar/kontraktuar nga këto OE apo BOE. Prandaj për vendosjen e këtij kriteri kërkohej një mendim i specializuar nga ana e APP, sidomos edhe nën optikën e kuadrit përkatës rregullator të ndryshuar rishtazi.

Në tërësi, duke marrë për bazë edhe DST e projekteve të tjera të ngjashme të hartuara dhe publikuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe/apo Spitale të tjera, SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë” është përpjekur maksimalisht që të rrisë në maksimum mundësitë e konkurimit të sa më shumë OE.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin mbetemi në pritje të një përgjigje sa më të shpejtë nga ana juaj.”

Më datë 14.04.2023, APP (përmes sistemit e-procurement) në përgjigje të kërkesës për asistencë të Njësisë së Prokurimit, dërgoi dokumentin e titulluar “Asistence” me përmbajtje si më poshtë:

“Përshëndetje,

Në lidhje me kërkesën për asistencë, për procedurën e prokurimit të Autoritetit Kontraktor “**Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”** (në vijim AK), me objekt “*Rikonstruksion, përforcim i godinës së Obstetrikës, rikonstruksion dhe termoizolim i fasadës së godinës së Gjinekologjisë dhe sistemimet e jashtme, brenda kompleksit të godinave të SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”*”, me fond limit 237,852,663 lekë pa TVSH, bazuar në dokumentacionin e paraqitur, rekomandojmë si më poshtë vijon:

Së pari, sugjerojmë plotësimin e seksionit 3.1 dhe 3.1.2 të DST, në lidhje përcaktimin e shumës së sigurimit të ofertës dhe në lidhje me llogarinë bankare, në përputhje me nenin 83 të LPP.

1. Në pikën 2.3.5/a të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “*Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:*

a) *Staf inxhinierik të përfshirë në licencën e shoqërisë (drejtues teknik)*

Për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, OE pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik të përfshirë në licencën e shoqërisë (drejtues teknik), si më poshtë:

- *Arkitekt min. 1 (një)*
- *Inxhinier Ndërtimi, profili strukturist min. 1 (një)*
- ***Inxhinier Ndërtimi, profili gjeoteknik min. 1 (një)***
- *Inxhinier Ndërtimi, profili hidroteknik min. 1 (një)*
- *Inxhinier Mekanik min. 1 (një)*
- *Inxhinier Mjedisi min. 1 (një)*
- *Inxhinier Elektrik min. 1 (një)*
- *Inxhinier Elektronik min. 1 (një)*
- *Inxhinier Gjeodet min. 1 (një)*
- *Inxhinier/arkitekt/ekspert i çertifikuar për efikasitetin e energjisë min. 1 (një)*

Për secilin nga të punësuarit e mësipërm, OE pjesëmarrës duhet të paraqesin:

- *Kontratë pune të vlefshme,*

- librezë pune,
- diplomë përkatëse,
- CV, si dhe
- të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit (Janar 2023 - Mars 2023) të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Për inxhinierin/arkitektin/ekspertin e çertifikuar për efikasitetin e energjisë, OE pjesëmarrës duhet të paraqesin edhe:

- Certifikatë të vlefshme për auditimin e energjisë në ndërtesa, lëshuar nga Agjencia për Efikasitetin e Energjisë”.

Së pari, sugjerojmë një rivlerësim të profilit gjeoteknik të kërkuar për inxhinierin e ndërtimit, duke mbajtur në konsideratë përcaktimet e pikës 1, të nenit 77, të LPP, që “...kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

Së dyti, në lidhje me kriterin e mësipërm përpara i përket **disponimit të audituesit të energjisë si të punësuar në stafin e OE**, sugjerojmë që AK të rishikojë hartimin e këtij kriteri, nisur nga fakti se audituesi i energjisë mund të sigurohet nga operatori ekonomik edhe me anë të marrëdhënies kontraktore për ekzekutimin e kontratës objekti prokurimi.

Rrjedhimisht, sugjerojmë rivlerësimin e kriterit për disponimin e audituesit të energjisë në listëpagesat e shoqërisë, duke lënë mundësinë e disponimit të këtij punonjësi nga operatori ekonomik edhe nëpërmjet **kontraktimit**.

Ky konstatim të mbahet në konsideratë edhe në lidhje me punonjësin “**Inxhinier/arkitekt/specialist/ekspert zjarrfikës**”, të kërkuar, në pikën 2.3.5/b, të kapacitetit teknik.

Së treti, sugjerojmë rivlerësimin e kërkesave për paraqitjen nga operatorët ekonomikë, në **fazën e ofertimit**, të dokumentacionit të kërkuar më sipër, për disponimin e punonjësit të kërkuar (kontratë pune), pasi këto kërkesa përmbushen nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Sjellim në vëmendje të AK, përcaktimet e pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “**Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit**, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”, për rrjedhojë sugjerojmë saktësimin e këtij përcaktimi, me qëllim shmangien e problematikave që mund të krijohen.

I njëjti konstatim sugjerojmë të mbahet në konsideratë edhe në gërmat e tjera të kësaj pike dhe pikave të tjera, të kapacitetit teknik.

2. Në pikën 2.3.5/d të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “**Ekspert mjedisi**

OE pjesëmarrës, duhet të kenë të punësuar në stafin e tij:

- **Ekspert mjedisi të pajisur me certifikatën (VNM) min. 1 (një)**

Për secilin nga të punësuarit e mësipërm, OE pjesëmarrës duhet të paraqesin:

- Kontratë pune të vlefshme,
- librezë pune,
- diplomë përkatëse,

- CV,
- **certifikatën e Vlerësimit e Ndikimit në Mjedis (VNM) e periudhës, si dhe**
- **të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit (Janar 2023 - Mars 2023) të deklaruar nga data e hapjes se ofertave”.**

Në lidhje me kërkesën për **Ekspert mjedisi të pajisur me certifikatën (VNM) min. 1 (një)**, duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen, vlerësojmë se AK nuk ka parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e ekspertit në fjalë. Sjellim në vëmendje të AK, në hartimin e kriterit për punonjësit, duhet t'i përmbahet përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, që *cdo kriter i vecantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës*. Për rrjedhojë, sugjerojmë AK të rivlerësojë nevojën në lidhje me vendosjen e kërkesës për **Ekspert mjedisi të pajisur me certifikatën (VNM) min. 1 (një)**.

Ky konstatim të mbahet në konsideratë edhe në lidhje me punonjësin **“Inxhinier materialesh”**, të kërkuar, në pikën 2.3.5/b, të kapacitetit teknik.

3. Në pikën 2.3.5/h të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: **“Inxhinier që disponojnë certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”**.

Operatorët ekonomikë, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre:

- **Inxhinier që disponojnë certifikatën si “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” min. 1 (një)”.**

Sugjerojmë mirëargumentimin e kërkesës që 1 (një) inxhinier të zotërojë certifikimin **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”**, pasi sipas Ligjit Nr. 10.237 date 18.02.2010 **“Për sigurinë dhe shëndetin në punë”**, i ndryshuar, **“Personi i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë” është një profesionist, i marrë në punë nga punëdhënësi dhe i caktuar për të kryer detyra, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë**” dhe për rrjedhojë vlerësojmë se nuk është e domosdoshme që inxhinierët të kenë certifikimet përkatëse të kërkuara nga AK, por do të mjaftonte **një punonjës përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë**.

I njëjti konstatim sugjerojmë të mbahet në konsideratë edhe për kërkesën që **punonjësit e trajnuar/certifikuar për punimet në lartësi** të jetë inxhinier, të kërkuar në pikën 2.3.5/g të kapacitetit teknik.

4. Te preventivi, AK i është referuar **markës/prodhues, “Knauf”...**, **“Armofleks”...**, si dhe për disa produkte që i kërkon **“Importi”...**, **“Cilësi e I-rë”...**

Sjellim në vëmendjen tuaj se, në nenin 36, pika 4, të LPP parashikohet se: *“Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”*.

Për sa më sipër, me qëllim shmangien e kufizimit të operatorëve ekonomikë, që tregtojnë produktet sipas kërkesave dhe specifikimeve të kërkuara nga AK, sugjerojmë që AK të rivlerësojë referencën e vendosur për markat apo origjinën e produktit.

Gjithashtu, sugjerojmë shmangien e përcaktimeve të tilla si “Cilësia e I-rë”, pasi mund të krijojë problematika në plotësimin e kriterit, apo në vlerësimin e ofertave dhe do të mjaftonte një përcaktim i qartë dhe i saktë i specifikimeve teknike dhe kërkesave që duhet të plotësojnë produktet.

5. Në lidhje me pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik, mbështetur në tipologjinë e objektit të kontratës që prokurohet, punimet konkrete që do të realizohen dhe volumet e tyre, rekomandojmë që AK të mirëargumentojë ose të rivlerësojë mjetet e kërkuara, konkretisht, numrin e lartë të ***mjeteve të gërmimit dhe mjeteve të transportit***, si dhe në rast se i qëndron kriterit, të mirëargumentojë teknikisht nevojën.
6. Në pikën 2.3.10 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “*Plani i organizimit / plani i sigurisë në kantier*”

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

PLAN - ORGANIZIMIN e punimeve të objektit ku te reflektoje te gjitha masat tekniko-organizative dhe elementet e tjere qe kerkon nje plan organizimi i mirëfilltë.

PLANIN E SIGURISE NE KANTIER per punimet ne objekt ne format sipas VKM nr. 692 date 13.12.2001 “Per masat e vecanta te sigurimit dhe ruajtjes se shendetit ne pune, te ndryshuar me VKM nr. 742 date 06.11.2003”, sipas kerkesave, si rrethimi provizor, depozitimi i materialeve kryesore, ambientet e kantierit, rruge kalimet, tabelat e sig. teknik etj”.

APP i sugjeron AK ta rivlerësojë kërkesën për paraqitjen e plan organizimit të punimeve dhe planin e sigurisë në kantier në objekt, si kërkesë të veçantë për kualifikim, duke u përmbajtur përcaktimeve të 39 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, pasi nuk është e qartë si do shërbejë për kualifikimin e ofertuesve, ndërkohë që një plan i tillë do shërbejë në fazën e zbatimit të kontratës.

7. Në pikën 2.3.8 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë konformiteti për tubat e bakrit që janë sipas standardit EN 13348 ose Ekuivalent, për përdorim mjekësor të lëshuara nga prodhuesi.*”

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë konformiteti për rekorderit e tubave të bakrit që janë sipas standardit ISO 2006:1981 ose Ekuivalent, për përdorim mjekësor të lëshuara nga prodhuesi”.

Së pari, në lidhje me kërkesat mbi paraqitjen e certifikatës së cilësisë së **prodhuesit**, duke mbajtur në konsideratë se:

- në nenin 79, pika 1, të LPP parashikohet se: “*Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit”.*
- në nenin 44, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 parashikohet se: “*Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga*

organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

- Operatorët ekonomikë ofertues në këtë procedurë, mund të mos jenë detyrimisht prodhues të mallit, dhe e sigurojnë mallin nga këta të fundit, apo distributorët e autorizuar prej tyre, rezulton se në këtë rast kërkesa për paraqitjen e certifikatës së cilësisë, të prodhuesit, mund t’i adresohet palëve të treta, të cilat mund të mos jenë konkurrent/kandidat në procedurën konkrete të prokurimit.

Për sa më lart, për rastet kur OE nuk është prodhues, rekomandojmë që AK të vlerësojë mundësinë e kërkesës/pranimit, të një vetëdeklarimi nga OE ofertues që në këtë rast, furnizuesi është konform standardeve të cilësisë, dhe të rezervojë të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit si dhe në rastin kur OE kualifikohet i pari, AK të kërkojë paraqitjen e certifikatës në fjalë.

Megjithatë, në rast të nevojës së pashmangshme për vendosjen e kriterit dhe kërkesës së certifikatave të cilësisë së prodhuesit, në përmbushje të përcaktimeve të nenit 78, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, rekomandojmë që AK të **mirëargumentojë në procesverbal** nevojën për paraqitjen e **certifikatës së cilësisë së prodhuesit**.

Së dyti, vihet re që AK i është referuar standardit **EN**.

Në kuptim të:

- nenit 36 të Ligjit nr. 162 date 23.12.2020, pika 3/b, që specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve;
- faktit që ekzistojnë standarde ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit,

rekomandojmë që AK të pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardeve shqiptare **SSH** mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

8. Në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik, AK ka kërkuar: “*Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:*

N-Z/ A/4 Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike

N-Z/ A/6 Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar”.

Në lidhje me licencat e kërkuara më sipër, sugjerojmë që AK të pranojë që operatorët ekonomikë të disponojnë këto licenca edhe nëpërmjet kontratës së bashkëpunimit ose mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera, sipas parashikimeve të nenit 84 të LPP dhe nenin 90 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar.

Përpos sa më lart, AK duhet të mbajë në konsideratë që, në zbatim të përcaktimeve të nenit 78, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, cdo kriter i vecantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht. Gjithashtu, sjellim në vëmendjen tuaj

se përlogaritja e vlerës së fondit limit duhet të argumentohet dhe dokumentohet sipas përcaktimeve të nenit 76, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Punë të mbarë!

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2 dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, dhe pas rekomandimeve të dhëna nga APP në bazë të kërkesës për asistencë, autoriteti/enti kontraktor Spitali Universitar Obstetrik – Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8,
- b) Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3
- c) Formularin e ofertës ekonomike, sipas Shtojcës 1 dhe listën e çmimeve sipas zërave të preventivit sipas Shtojcës 2.

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26 dhe 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe Vendimi nr.3 datë 09.06.2021 “Për miratimin e dokumentave standarte të tenderit për mallra, **punë**, shërbime për procedurën e prokurimit "procedurë e hapur”

ç. Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit, sipas shtojcës 2.

d. Preventivat e punimeve, sipas shtojcës 10

Për procedurën me objektin e sipërpërmendur është përzgjedhur Kriteret i vlerësimi të fituesit bazuar në Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në çmim

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022

Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, **në të paktën një vit të periudhës së kërkuar** nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe në pikën 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Përcaktimi i viteve (3 vitet e fundit financiar) të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2.2 Bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022

OE pjesëmarrës duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021 dhe 2022, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, **ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.**

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji."

2.2.3 Vërtetimet që janë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore

OE pjesëmarrës duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2021 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2022.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2022, sipas të dhënave të QKB-së.

Shënim: OE pjesëmarrës për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2021.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 76, pika 2, e LPP, si dhe nenit 39, pika 7/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kriteri i pikës 2.2.3 u vendos në referencë te nenit 76, pika 2 të ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe u vlerësua në zbatim të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe konkretisht në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në KREU II, Taksat Vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin e Taksave Vendore, (i ndryshuar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të ushtrojnë aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës, me qëllim që fituesi i mundshëm të jetë në gjendje për të zbatuar në mënyrë sa më korrekte kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme

Kriteri:

OE pjesëmarrës duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin:

- a) dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm, në një vlerë jo më të ulët se 30% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Dokumentacioni provues:

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të OE pjesëmarrës do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- (a) Për kontrata të realizuara me ente publike OE pjesëmarrës duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - (1) Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - (2) Kontratë Sipërmarrje;
 - (3) Situacionin përfundimtar;
 - (4) Aktin e kolaudimit;
 - (5) Certifikatën e marrjes në dorëzim/Certifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim.
- (b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, OE pjesëmarrës duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - (1) Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - (2) Kontratë Sipërmarrje;
 - (3) Situacionin përfundimtar;
 - (4) Aktin e kolaudimit;
 - (5) Certifikatën e marrjes në dorëzim/ Certifikatën e Përkohshme të marrjes në dorëzim;
 - (6) Fatura tatimore përkatëse.

Dokumentacioni provues extra:

Për kontratat e realizuara si BOE, OE ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe

- (1) Kontratën e BOE shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili OE anëtar i BOE.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, OE ofertues duhet të paraqesë:

- (1) Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe AK, si dhe
- (2) miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e AK.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 30 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 39, pika 5/a dhe b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Licencat profesionale të shoqërisë

Kriteri:

OE pjesëmarrës duhet të disponojnë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, të ndryshuar, në përputhje me zërat e punimeve që përfshihen në preventivin e punimeve, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

(a) Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- **N.P–1 A** Punime gërmimi në tokë;
- **N.P–2 A** Ndërtime civile e industriale;
- **N.P–3 D** Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash;
- **N.P–4 A** Punime në rrugë, etj.;
- **N.P–11 A** Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë;
- **N.P–12 A** Punime të inxhinierisë së mjedisit.

(b) Për punimet speciale të ndërtimit:

- (1) **N.S–1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve;
- (2) **N.S–2 A** Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- (3) **N.S–4 D** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues;

- (4) **N.S-12 A** Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit;
- (5) **N.S-13 A** Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni;
- (6) **N.S-14 A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV;
- (7) **N.S-18 A** Punime topogjeodezike.

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*. të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- (1) **N-Z/ A/4** Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike
- (2) **N-Z/ A/6** Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licenca/leje, lëshuar nga institucionet kompetente si më poshtë:

- (1) **III.2.B** Licencë për “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazinim, rikuperim të mbetjeve të llojeve të ndryshme”

Dokumentacioni provues:

Për të provuar disponimin e licencave profesionale të shoqërisë OE duhet të paraqesin

- (1) Originalin apo kopjen e licensave që ata disponojnë, ose
- (2) Kontratën e bashkëpunimit që vërteton mbështetjen e OE në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Për OE të huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës. Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). **Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.**

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Vendimit Nr.42, datë 16.2.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi“, i ndryshuar, sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI/MEI apo Ministria kompetente e linjës.

Kategoritë dhe nivelet e licencave të kërkuara janë bazuar në Lidhjen 3 dhe 4 të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve të preventivit, dhe janë si më poshtë:

Kategoria NP-1 A (Punime gjurmimi në tokë)

Konsiderohen gjërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise të punimeve, operatori ekonomik duhet të disponojë këte kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këte punime.

Kategoria NP-2 A (Ndërtime civile dhe Industriale)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose rishtrukturime me ndërhyrje të sakta, në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise të punimeve, operatori ekonomik duhet të disponojë këte kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këte punime.

Kategoria NP-3 D (Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash)

Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, rishtrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise të punimeve, operatori ekonomik duhet të disponojë këte kategori në nivelin D nga 101 deri në 200 milion lekë për këte punime.

Kategoria N.P-4 A Punime në rrugë, etje

Konsiderohen ndër të tjera rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrore dhe artificiale, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.

Sheshi brenda kompleksit të maternitetit do të shtrohet me shtresa rrugore dhe me asfalt për kalimin e automjeteve.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise të punimeve, operatori ekonomik duhet të disponojë këte kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këte punime.

Kategoria NP-11 A (Ndërtime, për N/Stacionet, kabinat e transformatoreve, linje të TN të mesme dhe shpërndarja të energjisë).

Konsiderohen Ndërtime, Mirëmbajtje ose rikonstruksione me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri tek përdoruesit të energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muratës, plotësuese ose ndihmëse të veçanta ose të rrjetit.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise të punimeve, operatori ekonomik duhet të disponojë këte kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këte punime.

Kategoria NP-12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose rishtrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik.

Referuar zerave të preventivit kemi të bëjmë me punime gjërmimi, ndërtimi, heqje dherash etj. që kanë ndikim negativ në mjedisin përreth. Gjate zbatimit të projektit në realizimin e plote të kontratës, është e pamëshueshme që në realizimin e punimeve të këte mbeturinë të inerte të cilat janë të një rrezikshmërie të lartë për komunitetin. Largimi dhe pastrimi i kantierit duhet të realizohet në përpikëri dhe në kohë reale.

Per kete arsye operatori ekonomik duhet te disponoje kete kategori ne nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë per keto punime.

Kategoria NS-1 A (Punime per prishjen e ndertimeve)

Konsiderohet çmontimi i impianteve industrial dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje special ose me përdorim eksploziv me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi, përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

Referuar zerave te preventivit kemi punime prishje të rifinituara, mureve, trotuareve, rrugës, bordurave etje, ku kontraktuesi duhet te marre masa qe te mbroje godinat, gardhet, muret rrethues dhe strukturat qe gjenden ne afersi te objektit, ku po kryhen keto punime prishese. Per kete, duhen evituar mbingarkesat nga te gjitha anet e strukturave nga grumbuj dhe materiale. Kur grumbujt dhe materialet duhen zbritur poshte, duhet pasur kujdes qe te parandalohet shperndarja ose renia e materialeve, ose te projektohet ne menyre te tille, qe mos te perbeje rrezik per njerezit, strukturat rrethuese dhe pronat publike te çdo lloji.

Per kete arsye operatorie ekonomik duhet te disponoje kete kategori ne nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë per keto punime.

Kategoria NS-2 A (Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre)

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturimi impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundërzjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Referuar zerave te preventivit dhe sasise se punimeve te cilat perfshijne punimet per nyjet sanitare, dhe gjithë impiantet e mbrojtjes ndaj zjarrit, operatori ekonomik duhet te disponoje kete kategori ne nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë per keto punime.

Kategoria NS-4 D (Punime rifinature te muratures dhe te lidhura me to, rifinature me materiale druri, plastike, metalik dhe xhami dhe rifinature te natyres teknike ndertuese)

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja ose ristrukturimi i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdolloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipave të ndryshme.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

Referuar zerave te preventivit dhe sasise se punimeve te cilat perfshijne te gjithë zerat e permendur me siper duke përfshirë dhe punimet e përforcimit të godinës së Obstetrikës, fasadës së Gjinekologjisë etje. Konkretisht i gjithë objekti i prokurimit është lidhur me punime rifinature, kësioj operatori ekonomik duhet te disponoje për këtë kategori punimesh, nivelin D nga 101 deri në 200 milion lekë.

Kategoria NS-12 A (Impiante teknologjik, termike dhe te kondicionimit)

Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në process realizimi.

Referuar zerave te preventivit dhe sasise se punimeve te cilat perfshijne te gjithë zerat e permendur me siper, operatori e ekonomik duhet te disponoje kete kategori ne nivelin B nga 21 deri në 50 milion lekë per keto punime.

Kategoria N.S - 13 A (Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunicacioni)

Konsiderohen montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike te jashtme dhe impiante te telekomunikacionit me frekuence te larte, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar te ndara nga zbatimi i sistemeve te tjera qe jane realizuar ose jane duke u realizuar ne punimet e pergjithshme.

Referuar zerave te preventivit dhe sasise se punimeve te cilat perfshijne te gjithë zerrat e permendur me siper, operatori e ekonomik duhet te disponoje kete kategori ne nivelin B nga 21 deri në 50 milion lekë per keto punime.

Kategoria NS-14 A (Impiante te brendeshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni Tv etj)

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

Referuar zerave te preventivit dhe sasise se punimeve te cilat perfshijne punimet per nyjet sanitare, dhe gjithë impiantet e mbrojtjes ndaj zjarrit, operatori ekonomik duhet te disponoje kete kategori ne nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë per keto punime.

Kategoria NS-18 A (Punime Topogjeodezike)

Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike special që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime specialegeodezike; rrjeta

Ne kete obejkt perfshihen edhe punime si piketimi, rlevime të ndryshme topografike në sisteme koordinative të ndryshme caktimi i kuotave te kërkuara nga projekti, azhornime të ndryshme dhe lidhjet me sistemet koordinative relative dhe absolute.

Referuar zerave te preventivit dhe sasise se punimeve te cilat perfshijne punimet per nyjet sanitare, dhe gjithë impiantet e mbrojtjes ndaj zjarrit, operatori ekonomik duhet te disponoje kete kategori ne nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë per keto punime.

N-Z/ A/4 – “Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike” dhe N-Z/ A/6 – “Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar”

Kërkesa për disponimin e licencave N-Z/ A/4 – “Zbatim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike” dhe N-Z/ A/6 – “Zbatim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar” është vendosur për faktin se kjo godinë është shpalluar monument Kulture i kategorisë së dytë nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve me Vendim nr.122 dt.05.03.2007, si dhe në përputhje me ligjin 27/2018 “Për trashëgëminë kulturore dhe muzetë”, Vendimit Nr. 792, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale”.

III.2.B - Licencë për “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazininim, rikuperim te mbetjeve te llojeve te ndryshme”

Kërkesa për disponimin e licencës III.2.B - Licencë për “Grumbullim, transportim, ruajtje/magazininim, rikuperim te mbetjeve te llojeve te ndryshme” është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe lidhet me standartet e menaxhimit mjedisor Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë licensat profesionale të domosdoshme për kryerjen grumbullimin e ruajtjen dhe transportimin embetjeve ne kantier. Gjithashtu duke qenë se rehabilitimi dhe përforcimi i objekteve, në një kompleks spitalor dhe në një zonë urbane me dendësi të lartë,do të prodhoj mbetje të ndryshme, ku nevojitet eksperienca dhe licenca përkatëse për menaxhimin,

grumbullimin dhe magazinimin e tyre bazuar në Ligjin Nr.10 463, datë 22.9.2011”Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” dhe Ligjin Nr. 10 431, datë 9.6.2011”Për Mbrojtjen e Mjedisit”

2.3.3 Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:

Për të provuar fuqinë e tij punëtore, OE duhet të vërtetojë se plotëson kriteret e mëposhtme përsa i përket:

- a) punonjësve domosdoshmërisht të përfshirë në licencën e shoqërisë (drejtues teknik);
- b) punonjësve jo domosdoshmërisht të përfshirë në licencën e shoqërisë por që mund të kontraktohen për nevoja të realizimit të kontratës objekt prokurimi;
- c) punonjësve domosdoshmërisht të përfshirë në listëpagesat e OE, minimalisht në 3 (tre) muajt e fundit (Janar 2023 - Mars 2023) të deklaruar nga data e hapjes së ofertave;
- d) punonjësve të specializuar/të kualifikuar;
- e) punonjësve të trajnuar/certifikuar për punimet në lartësi dhe sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë;
- f) punonjësve - mjek i përgjithshëm;
- g) numrit minimal të punëtorëve të punësuar.

a) Punonjësit domosdoshmërisht të përfshirë në licencën e shoqërisë (drejtues teknik)

Kriteri:

Për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, OE pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar punonjës (me eksperiencë pune minimalisht 2 (dy) vjeçare) domosdoshmërisht të përfshirë në licencën e shoqërisë (drejtues teknik), si më poshtë:

- | | |
|--|--------------|
| (1) Inxhinier ndërtimi - profili strukturist | min. 1 (një) |
| (2) Inxhinier mekanik | min. 1 (një) |
| (3) Inxhinier gjeodet | min. 1 (një) |

Dokumentacioni provues:

Për secilin punonjës të mësipërm, OE pjesëmarrës duhet të paraqesin:

- (1) kontratë pune të vlefshme me punëmarrësin;
- (2) librezën e punës së punëmarrësit;
- (3) diplomën përkatëse të punëmarrësit;
- (4) CV e punëmarrësit;
- (5) dokumentacionin që provon faktin që punëmarrësi figuron në listëpagesat e OE, minimalisht në 3 (tre) muajt e fundit (Janar 2023 - Mars 2023) të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

b) Punonjësit jo domosdoshmërisht të përfshirë në licencën e shoqërisë por që mund të kontraktohen për nevoja të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Kriteri:

Për kryerjen e punimeve në objekt, OE pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar punonjës (me eksperiencë pune minimalisht 2 (dy) vjeçare) jo domosdoshmërisht të përfshirë në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- | | |
|--|--------------|
| (1) Arkitekt | min. 2 (dy) |
| (2) Inxhinier elektrik | min. 2 (dy) |
| (3) Inxhinier i diplomuar në Teknologji Informacioni | min. 1 (një) |
| (4) Inxhinier ndërtimi - profili hidroteknik | min. 1 (një) |
| (5) Inxhinier mjedisi | min. 1 (një) |
| (6) Inxhinier elektronik | min. 1 (një) |
| (7) Inxhinier/arkitekt/ekspert i çertifikuar për efikasitetin e energjisë | min. 1 (një) |
| (8) Inxhinier/arkitekt/specialist/ekspert zjarrfikës në fushën e mbrojtjes | |

Dokumentacioni provues:

Për secilin nga punonjësit e mësipërm, OE pjesëmarrës duhet të paraqesin:

- (1) kontratë pune të vlefshme me punëmarrësin;
- (2) librezën e punës së punëmarrësit;
- (3) diplomën përkatëse të punëmarrësit;
- (4) CV e punëmarrësit.

Dokumentacioni provues extra:

Përsa i përket stafit të mësipërm të profilit: “(7) Inxhinier/arkitekt/ekspert i çertifikuar për efikasitetin e energjisë”, përveç dokumentacionit të mësipërm, OE pjesëmarrës duhet të paraqesin si dokumentacion provues edhe:

- (5) certifikatë të vlefshme të punëmarrësit për auditimin e energjisë në ndërtesa, lëshuar nga Agjencia për Efikasitetin e Energjisë.

Përsa i përket stafit të mësipërm të profilit: “(8) Inxhinier/arkitekt/specialist/ekspert zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, përveç dokumentacionit të mësipërm, OE pjesëmarrës duhet të paraqesin si dokumentacion provues edhe:

- (5) certifikatë të vlefshme përkatëse të punëmarrësit dhënë nga Drejtoria e MZSH.

c) Punonjësit domosdoshmërisht të përfshirë në listëpagesat e OE, minimalisht në 3 (tre) muajt e fundit (Janar 2023 - Mars 2023) të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.

Kriteri:

Për kryerjen e punimeve në objekt, OE pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar punonjës (me eksperiencë pune minimalisht 2 (dy) vjeçare), si më poshtë:

- | | |
|---------------------|--------------|
| (1) Teknik ndërtimi | min. 2 (dy) |
| (2) Teknik elektrik | min. 1 (një) |
| (3) Teknik mekanik | min. 1 (një) |

Dokumentacioni provues:

Për secilin nga të punësuarit e mësipërm, OE pjesëmarrës duhet të paraqesin:

- (1) kontratë pune të vlefshme me punëmarrësin;
- (2) librezën e punës së punëmarrësit;
- (3) dokumentacionin që provon faktin që punëmarrësi figuron në listëpagesat e OE, minimalisht në 3 (tre) muajt e fundit (Janar 2023 - Mars 2023) të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- (4) dëftesë të shkollës së mesme profesionale ose diplome bachelor të punëmarrësit.

d) Punonjësit të specializuar/të kualifikuar

Kriteri:

Për kryerjen e punimeve në objekt, OE pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar punonjës, si më poshtë:

- | | |
|--|----------------|
| (1) Hidraulikë | min. 3 (tre) |
| (2) Elektricitetë | min. 3 (tre) |
| (3) Instalues dhe mirëmbajtës i sistemeve ngrohëse – ftohëse | min. 1 (një) |
| (4) Hekurkthyes | min. 4 (katër) |
| (5) Karpentier | min. 4 (katër) |
| (6) Hidroizolues | min. 4 (katër) |
| (7) Murator/suvaxhi | min. 8 (tetë) |

(8)	Bojaxhi	min. 5 (pesë)
(9)	Shtrues pllakash	min. 6 (gjashtë)
(10)	Saldator	min. 2 (dy)
(11)	Teknik ashensori	min. 1 (një)
(12)	Specialist për punime durale	min. 2 (dy)
(13)	Specialist për punime gipsi	min. 2 (dy)
(14)	Eskavatorist	min. 2 (dy)
(15)	Automakinist	min. 4 (katër)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, OE pjesëmarrës duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr. NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

Dokumentacioni provues:

Për secilin nga të punësuarit e mësipërm, OE pjesëmarrës duhet të paraqesin:

- (1) kontratë pune të vlefshme me punëmarrësin;
- (2) librezën e punës së punëmarrësit;
- (3) një dokument që të vërteton kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore;
- (4) dëshmi të vlefshme kualifikimi të sigurimit teknik, lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve nga autoritetet përgjegjëse shtetërore.

Dokument provues alternativ:

Përsa i përket stafit të mësipërm të profilit: “(14) Eskavatorist”, dhe “(15) Automakinist”, në rastin kur mjetet/makineritë disponohen me qira nga OE, në vend të “kontratës së vlefshme të punës me punëmarrësin” OE mund të paraqesë si dokumentacion provues:

- (1) kontratë pune të vlefshme që qiradhënësi ka me punonjësin dhe kontratën e marrjes me qira të mjetit/makinerisë ndërmjet OE dhe qiradhënësit.

e) Punonjësit të trajnuar/certifikuar për punimet në lartësi dhe sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë

Kriteri:

Për kryerjen e punimeve në objekt dhe në respektim të përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”; OE pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar punonjës, si më poshtë:

- (1) punonjës të trajnuar/certifikuar për punimet në lartësi min. 4 (katër)
- (2) punonjës që disponon certifikatën si përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë min. 1 (një)

Dokumentacioni provues:

Për secilin nga të punësuarit e mësipërm, OE pjesëmarrës duhet të paraqesin:

- (1) kontratë pune të vlefshme me punëmarrësin
- (2) librezën e punës së punëmarrësit.

Dokumentacioni provues extra:

Përsa i përket stafit të mësipërm të profilit: “(1) punonjës të trajnuar/certifikuar për punimet në lartësi”, përveç dokumentacionit të mësipërm, OE pjesëmarrës duhet të paraqesin si dokumentacion provues edhe:

- (3) certifikata trajnimi për “Punimet në lartësi D.P.I., Rënia nga lartësitë, Punimet në lartësi D.P.I. skela, shkallë, skarpate etj.” e dhënë nga një organizëm certifikimi i akredituar shqiptar ose i huaj.

Përsa i përket stafit të mësipërm të profilit: “(2) punonjës që disponon certifikatën si përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, përveç dokumentacionit të mësipërm, OE pjesëmarrës duhet të paraqesin si dokumentacion provues edhe:

- (3) diplomën/certifikatën përkatëse.

f) Punonjësit - mjek i përgjithshëm**Kriteri:**

Për kryerjen e punimeve në objekt dhe në respektim të përcaktimeve të bëra në paragrafin 12/2 të VKM nr. 692, datë 13.12.2001 “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, i ndryshuar dhe të Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, dhe VKM nr. 108, datë 9.2.2011 “Për aftësi që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, i ndryshuar; OE pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar punonjës, si më poshtë:

- (1) Mjek të përgjithshëm min. 1 (një)

Dokumentacioni provues:

Për secilin nga të punësuarit e mësipërm, OE pjesëmarrës duhet të paraqesin:

- (1) kontratë pune të vlefshme me punëmarrësin ose kontratë të vlefshme me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim;
- (2) librezën e punës së punëmarrësit;
- (3) diplomën universitare të punëmarrësit;
- (4) licencën përkatëse të punëmarrësit për ushtrimin e profesionit (urdhëri i mjekut).

g) Numri minimal i punëtorëve të punësuar**Kriteri:**

Për kryerjen e punimeve në objekt, OE pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë të paktën 100 (një qind) punonjës.

Dokumentacioni provues:

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- (1) kontratë pune të vlefshme me punëmarrësin;
- (2) librezën e punës së punëmarrësit;
- (3) dokumentacionin që provon faktin që punëmarrësi figuron në listëpagesat e OE, minimalisht në 3 (tre) muajt e fundit (Janar 2023 - Mars 2023) të deklaruar nga data e hapjes së ofertave;
- (4) vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e fundit të deklaruar;
- (5) listëpagesat e deklaruar në organet tatimore bazuar në VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve” për periudhën e kërkuar me sipër.

Shënim:

Në rastin e ofertave të paraqitura nga një BOE, kriteret e mësipërme mjafton që të plotësohen edhe vetëm nga njëri prej OE pjesë e BOE në përputhje me zërat e punimeve/shërbimeve/mallit që janë marrë përsipër që të realizohen sipas akt marrëveshjes nga OE.

Me anë të një deklarate të nënshkruar nga Administratori i shoqërisë, OE pjesëmarrës duhet të përcaktojë “Përgjegjësin teknik të kantierit”, ku të theksohet që: “Përgjegjësi teknik i kantierit do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në asnjë kontratë tjetër përveç kontratës objekt prokurimi nga AK”. Përgjegjësi teknik i kantierit duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”.

Në zbatim dhe të rekomandimit paraparak të APP-së dhënë mbi draftin e DST-së, **në fazën e ofertimit dhe vlerësimit të ofertave nga KVO**, kërkesat e mësipërme në lidhje me dokumentacionin provues, konsiderohen se janë plotësuar edhe thjesht nëpërmjet paraqitjes nga OE pjesëmarrës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, **por më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, në zbatim të përcaktimeve të bëra në nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, OE duhet të paraqesë dokumentacionin që provon plotësimin e këtyre kërkesave, ose në variantin e tyre origjinal ose në variantin e kopjes së njehsuar me origjinalin, ose nëse kërkohen sqarime nga AK.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c dhe 6/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

*Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Bazuar në parashikimet e legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.*

Kërkesa specifike për Inxhinierët dhe Arkitektët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkërendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas pikës 2.4, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbeshtetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Inxhinieret kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Gjithashtu dhe arkitektët, të cilët duhen dy për shkak se objekti i prokurimit përfshin disa ndërhyrje duke filluar nga rehabilitimit fasadës monument kulture, rikonstruksioni dhe përshtatja e ambjenteve të gjithë godinës së Obstetrikës, sistemimet e jashtme me gjelbërim, trotuare, rrugë etje dhe rikonstruksioni i fasadës së objektit të Gjinekologjisë.

Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Stafi i inxhinierëve, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët

ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Me qëllim që punimet e ndërtimit të realizohen nga ana e operatorit ekonomik, në zbatim të rregullave të sigurimit teknik detyrimisht kerkohet nje staf teknik i specializuar. Ky kriter eshte vendosur ne mbeshtetje të pikës 4 të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020, për “Prokurimin publik”, ku citohet **“4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.**

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP - 1, NP - 2, NP – 3, NP – 4, NS - 1, NS - 4**, eshte e nevojshme prezenca e **Arkitektit dhe Inxhinierit të Ndërtimit (Strukturist)**. Ne kete veper parashikohet përforcimi themelit me betonarme dhe përforcimi i mureve me shtresë betoni dhe zgarë, gjithashtu ndërtimi i një shtesë beton arme, rikonstruksioni i fasadës së Obstetrikës, Gjinekologjisë, sistemimet e brendshme të Obstetrikës dhe sistemimet e jashtë të kompleksit brenda spitalit.

- e **Inxhinierit Hidroteknik**. Parashikohet ndërtimi i rrjetit uji i ngrohtë dhe uji i ftohtë i pasijur me aparate sanitare dhe rrjeti i shkarimit t ujerave të zeza bashkrenduar me kategorine e licensës **N.S - 2**.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP - 11, NS - 14** eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Elektrik**. Ne kete veper nje pjese te rendesishme zene punimet per instalimet elektrike.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS -18** eshte e nevojshme prezenca e një **Inxhinier Gjeodet/Topograf/**, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS – 12**, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinier Mekanik**, pasi kjo veper parashikon realizimin e sistemeve HVAC dhe tubacioneve të gazit mjeksor.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS – 13, NS - 14** eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinier Elektronik/Informatik/Telekomunikacion** pasi kemi punime në sistemin e monitorimit/vëzhgimit CCTV dhe sistemin telefonik dhe kompjuterik si edhe sistemin zanor.

- Referuar në preventivin e punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **N.P - 12** “Punime të inxhinierisë së mjedisit” eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Mjedisit**.

- **Inxhinier/Arkitekt ekspert i certifikuar nga AEE për eficientë e energjisë**, kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në licencën N.S – 4 që ka të bëjë me punimet e rifiniturës të cilat përfshijnë zërat për rritjen e performancës së energjisë në strukturat që do të nënshtrohen rikonstruksionit dhe vendosjes së sistemeve HVAC dhe sistemeve të furnizimit me energji dhe furnizimit me ujë të ngrohtë, nenin 79 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, Ligjin Nr. 124/2015 “Për Eficientë e Energjisë” dhe Ligjin Nr. 116/2016 “Për Performancën e Energjisë në Ndërtesa”.

• **Eksperti zjarrefiks**

Ky kriter është vendosur gjithashtu në përputhje të plotë me Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik”, Neni 77, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39, pika 6/ç, si dhe me aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi për kërkesat teknike “Për mbrojtjen kundra zjarrit” në ndërtesat publike.

Është arsyetuar e nevojshme dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës vendosja e kësaj kërkesë për operatorin ekonomik pasi në procesin e ndërtimeve të rikonstruksioneve dhe përshtatjeve të objekteve, është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë pjesë të stafit të certifikuar ekspert të trajnuar për

mbrojtjen kundra zjarrit me qëllim ndjekjen e zbatimit të normave dhe rregullave në lidhje me ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa. Në Nenin 27 të ligjit Nr.8766, datë 05.04.2001 "Për mbrojtjen nga zjarri", i ndryshuar, citohet: **"Projektimi, ndërtimi, rikonstruksioni dhe vënia në shfrytëzim e veprave dhe e objekteve të ndryshme, ndërtesave, rrjetit rrugor elektrik, ujësjellës-kanalizimeve etj. bëhen në përputhje edhe me kërkesat e këtij ligji, me normat dhe rregulloret për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin, me rregullat dhe normat ndërkombëtare teknike, si dhe me rregullat e përcaktuara në dispozita të veçanta"**.

Referuar objektit të kësaj procedure prokurimi, si dhe bazuar mbi këtë legjislacion detyrues, në funksion të kontrollit të zbatimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit në ndërtimet e reja, si dhe rikonstruksionin e ndërtesave ekzistuese është e nevojshme që operatori ekonomik të jetë i licencuar mbi masat e mbrojtjes nga zjarri të ndërtesave pasi çdo vepër e përfunduar duhet të jetë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Kategoria I.2.A "Shërbime ekspertize" specifikon shërbime këshillimi, projektimi, planifikimi, vlerësimi i dëmeve, informimi, edukimi në sferën e mbrojtjes civile apo specifikime të tjera sipas rastit.

- **Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë**

Ky kriter është vendosur në mbështetje të pikës 4 të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.13.2020, "Për prokurimin publik", në VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", neni 39, pika 6/ç, si dhe ne zbatim ne të nenit 7 të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" ku citohet..... *"Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion"*, si dhe VKM Nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Ky kriter ka si qëllim te garantojë sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë nga operatori ekonomik pjesëmarrës nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimit, këshillimit, pjesëmarrjes së balancuar, në përputhje me ligjin, formimit të punëmarrësve e të përfaqësuesve të tyre.

Punëdhënësit janë të detyruar të ndjekin rregulla të përgjithshme të parandalimit të rrezikut duke mbajtur parasysh natyrën e veprimtarisë së ndërmarrjes/institucionit; vlerësimin e rrezikshmërisë ndaj sigurisë dhe shëndetit të punëmarrësve.

Specialisti per sigurimin teknik dhe shendetin ne pune duhet të jetë një profesionist, i cili harton planin e sigurisë dhe të koordinimit ne kantier, parapërgatit një dosje, e cila përmban informacionet e nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen nga rreziqet ndaj të cilave janë të ekspozuar punëtorët, harton planin operativ të sigurisë, kryen mirëmbajtjen e kontrollin para fillimit të punës dhe kontrollin periodik të impianteve dhe pajisjeve të punës me qëllim eliminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë ose shëndetin e punëmarrësve.

- **Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave**

Përcaktimi i këtij kriteri eshte bere referuar objektit te prokurimit ,volumit te punimeve si dhe zerave te percaktuar ne preventiv .

- **Eksperti i mjedisit**

Qëllimi për vendosjen e këtij kriteri është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, nëpërmjet parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve. Vlerësimin e ndikimeve negative mjedisore në kohën e duhur dhe parandalimin e tyre.

Në pikën 4, Nenin 24 të ligjit Nr.10440, datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin E Ndikimit Në Mjedis" përcaktohet se liçencat e këtyre ekspertëve përfshihen në kategorinë III.2 të shtojcës së ligjit për liçencat. Veprimtaritë e nënkategorisë III.2.A specifikohen në vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe në auditimin mjedisor.

- **Mjeku i përgjithshëm**

Gjithashtu, në referencë të frymës së ligjit për prokurimin publik dhe konkretisht të nenit pikës 4 të nenit 77, i cili përcakton se ofertuesit, të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e **nevojshme teknike, profesionale**, aftësitë organizative, **reputacionin dhe besueshmërinë**, përvojën e duhur, si dhe **personelin e nevojshëm**, për të zbatuar kontratën, është kërkuar **një mjek**, në nenin 39, pika 6/ç të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, bazuar në nr.742, datë 06.11.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.692, datë 13.12.2001, të Këshillit të Ministrave” përmasat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë” është përcaktuar: “2/1. Punëdhënësi siguron funksionimin e shërbimit mjekësor, nëpërmjet mjekut të ndërmarrjes, në të gjitha subjektet që ushtrojnë veprimtari prodhuese, private ose shtetërore, vendase ose të huaja, juridike ose fizike.”, si dhe në Paragrafin 12/2 të Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.

Mjekët e ndërmarrjes pajisen me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë, në përputhje me Vendimin nr.500, datë 23.11.1992 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien e licencave për ushtrimin e profesionit në fushën e mjekësisë, në profesion të lirë privat”, i ndryshuar. Marrëdhëniet ndërmjet punëdhënësit dhe mjekut të ndërmarrjes përcaktohen në bazë të kontratës së punës që lidhin palët, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- **Manovratorët eskavatorist, makinist etje.**

Përcaktimi i këtij kriteri është referuar objektit të prokurimit si dhe volumit të punimeve si dhe zerave të përcaktuara në preventiv në bazë të mjeteve dhe makinerive të kërkuara.

- **Punësimi mesatar**

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” ku citohet “*Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës*” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i punonjësve është përcaktuar referuar volumeve të punës që do të kryhen, afatit të realizimit të kontratës objekt prokurimi, si dhe grafikut të punimeve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor me qëllim realizimin me sukses të kontratës.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, orët e punës sipas manualit të ndërtimit dhe volumet totale për secilin zë punimesh në preventiv.

Numri i stafit kryesor dhe mbështetës është llogaritur në bazë të volumeve dhe grafikut të punimeve.

- **Teknikët dhe punonjësit e specializuar/të kualifikuar**

Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes që do të realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve të percaktuara në specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/deshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë të lëshuara nga institucione të licensuara nga organet përkatëse, mbështetur në Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se.

2.3.4 Mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike

Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 Ton ose 10-20 Ton	në pronësi ose me qira	2
2	Kamionçinë vetëshkarkuese me kapacitet mbajtës 1.5 - 3.5 Ton	në pronësi ose me qira	1
3	Autovinç me kapacitet mbajtës 10-16 Ton	në pronësi ose me qira	1
4	Autovinç teleskopik me kapacitet ngritës min. 25 Ton	në pronësi ose me qira	1
5	Autobetoniere	në pronësi ose me qira	2
6	Autopompë Betoni	në pronësi ose me qira	1
7	Autobot uji me kapacitet min. 15.000 Litra	në pronësi ose me qira	1
8	Minifadrom me kovë para	në pronësi ose me qira	2
9	Eskavator 0.5 m³ për punimet e gërmimit	në pronësi ose me qira	1
10	Fadrom me goma me kovë para mbrapa	në pronësi ose me qira	1
11	Automjet për transportin e llumrave dhe për pastrimin e tubave	në pronësi ose me qira	1
12	Pajisje për ngjitjen e tubave metalik/bakri me dimensione 6 – 150 mm	në pronësi ose me qira	1
13	Pajisje për Llustrim/ Lavigim të pllakave/ mermerëve/ shtresave të betonit	në pronësi ose me qira	1
14	Lazer nivelues 360° për shtresat dhe tavanin	në pronësi ose me qira	2
15	Pompë Suvatimi	në pronësi ose me qira	2
16	Rrul ngjeshës deri CBR≥35%	në pronësi ose me qira	1
17	Betonforma/skeleri betoni	në pronësi ose me qira	200 m²
18	Autokullë ndriçimi me gjenerator	në pronësi ose me qira	1
19	Skeleri fasade	në pronësi ose me qira	2000 m²
20	Platformë ngritëse vertikale 7m, 250kg	në pronësi ose me qira	1
21	GPS + Total station / ekuivalent me certifikatë kalibrimi të vlefshme	në pronësi ose me qira	1
22	Vibrator Betoni Thellësie	në pronësi ose me qira	2
23	Makineri për torketimin e betonit me presion	në pronësi ose me qira	1
24	Grejder	në pronësi ose me qira	1
25	Asfalto shtruese	në pronësi ose me qira	1
26	Pompë torketimi për hedhjen e betonit me presion të lartë	në pronësi ose me qira	1

27	Set laborator për testimin e betonit, gurëve, asfalteve dhe llojeve të ndryshme të dherave sipas Direktivave Europiane 2006/42/CE, 2014/35/UE, 2014/30/UE, BS 1377:2, BS6576 + Certifikatë konformiteti	në pronësi ose me qira apo me kontratë shërbimi	1
----	---	---	---

Operatori ekonomik duhet të disponojë mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

Nr	Lloji i pajisjeve (PMI)	Statusi	Sasia
1	Kokore	në pronësi	100 copë
2	Syze transparente për mbrojtjen e shikimit gjatë punës	në pronësi	50 copë
3	Kufje për mbrojtjen e dëgjimit	në pronësi	10 copë
4	Doreza pune	në pronësi	100 copë
5	Rip/litar sigurimi	në pronësi	6 copë
6	Fikse Zjarri	në pronësi	20 copë
7	Tabela Sigurimi Teknik	në pronësi	40 copë
8	Jelek	në pronësi	100 copë
9	Kuti Ndihme e shpejt	në pronësi	10 copë

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit: certifikatën e pronësisë; leja e qarkullimit; certifikatën e kontrollit teknik; siguracionin; leja e transportit (për vete ose për të tretë) që lëshohet nga njësi vendore dhe fotot përkatëse.

Ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata noteriale të qirasë dhe duhet të jete e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronësi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore përkatëse, fotot, ndërsa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mësipërm, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirasë dhe duhet të jete e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara në procedurë të shpallura fitues.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtoare, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zerave specifike të punimeve në proceset e punës, volumet e punimeve të preventivit dhe grafikut të punimeve të kryera gjatë javës ku shënohet dhe piku i punimeve dhe duke u bazuar në shpërndarjen e punimeve në objekt dhe certifikatën e kontrollit teknik të mjeteve rrugore.

Numri i mjeteve është përcaktuar në varesi të volumeve të punimeve. Gjithashtu në referencë të frymës së ligjit për prokurimin publik dhe konkretisht të nenit 77, pika 4, i cili përcakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale,

aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, në zbatim të gjithë legjisllacionit në Republikën e Shqipërisë, lidhur me ambientin.

Gjithashtu në këtë kriter është vendosur kërkesa për pajisjet mbrojtëse për punëorët, në referencë të VKM nr.692, dt.13.12.2001, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, i ndryshuar, me VKM Nr. 742, dt.06.11.2003 “Për masat e vecanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë”, i cili përcakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm, të vërtetojnë se zotërojnë mjetet dhe pajisjet mbrojtëse në punë të punëtorëve, të nevojshme të sigurimit teknik duke patur parasysh larmishmërinë dhe volumin e punëve që do të kryhen si dhe afatin e realizimit të kontratës.

Vendosja e kriterit teknik “Deklarim nga administratori i shoqërisë mbi vendodhjen e mjeteve në Formularin permbledhes te vetedeklarimit” për mjetet që disponon për realizimin e kontratës, është bërë për të bindur Autoritetin Kontraktor se operatori ekonomik i ka të lira këto mjete që ka deklaruar dhe se është i afte për realizimin në kohë dhe cilësi kontratën, objekt prokurimi. Ky kriter është vendosur në referencë të nenit 39 “Kontratat për punë publike”, pika 6/d, të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.5 Standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit

Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme:

- Certifikatë **ISO 9001 - 2015** (ose e përditësuar) mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë;
- Certifikatë **ISO 45001 - 2018** (ose e përditësuar) mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë” lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë;
- Certifikatë **ISO 14001 - 2015** (ose e përditësuar) mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë;
- Certifikatë **ISO 50001 - 2011** (ose e përditësuar) mbi “Sistemin e menaxhimit të energjisë” lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, dhe nenin 79 të LPP, nenin 39, pika 8, dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Të gjitha certifikata e mesiperme duhet të jene të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Legjisllacioni në fuqi për prokurimin publik i jep mundësinë autoriteteve kontraktore që të kërkojnë certifikime nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar, në mënyrë që të vërtetojnë se punët që kërkohet të realizohen nga operatorët ekonomik, do të jenë sipas kërkesave të cilësisë.

Kriteri i vendosur në referencë të dispozitave të sipërcituar, i cili përcakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm, vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, dhe duhet të jetë i pajisur me **certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë**, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. Që të realizohet me cilësi dhe konform standarteve procedura, objekt prokurimi, operatori

duhet të jetë i çertifikuar me certifikatat ISO të menaxhimit si më sipër, të cilat në rastin konkret vlerësohen të nevojshme përsa i përket cilësisë dhe sigurisë në punë. Pra konsiderohet si kriter i lidhur ngushtësisht me objektin e kontratës që prokurohet dhe i bazuar në LPP.

Keto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pranohet edhe certifikata ekuivalente të tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardin për menaxhimin e mjedisit shëndetit dhe sigurisë në punë

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtare, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 50001-2011 është standard ndërkombëtare, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e energjisë.
• *Certifikatë ISO 13485:2016 (ose e përditësuar) mbi "Projektim, ndërtim, mirëmbajtje dhe asistencë teknike e sistemeve të shpërndarjes së gazrave mjeksore dhe vakumit; AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me këtë certifikatë për të garantuar realizimin me cilësi dhe sipas normativave sistemin e gazrave mjeksor të parashikuara në projekt.*

2.3.6 Autorizimet e prodhuesit / marrëveshjet e bashkëpunimit me prodhuesin / autorizimet e distributorit

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose marrëveshje bashkëpunimi me prodhuesin, ose autorizim distributori ku të autorizohet ofertuesi për këtë procedurë prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit të autorizuar si: Tel/fax/email. Ofertuesi të paraqesë katalogë ose fragmente të katalogut të prodhuesit për materialet dhe pajisjet e mëposhtme:

- (1) Sistemeve HVAC
- (2) Sistemit të ndriçimit
- (3) Hidrosanitare
- (4) Bojra
- (5) Pllaka dhe shtresën e dyshemesë së brendshme
- (6) Polisterolet
- (7) Dritaret duralumin plastike termike
- (8) Xhamat

- (9) Vettrat/dyert e brendshme me konstruksion alumini të galvanizuar dhe xham triplex
- (10) Ashensor
- (11) Tubat PPR, HDPE etj.
- (12) Sisteme thirrjes-Nurse call
- (13) Sistemin antizjarr

Deklarata konformiteti

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një ose disa deklarata konformiteti për të gjithë pjesët përbërëse të sistemit të gazeve mjekësor duke nisur nga tubat e bakrit mjekësor dhe deri tek njësitë terminale (prizat) e gazeve mjekësore të lëshuara nga prodhuesi.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë konformiteti për tubat e bakrit që janë sipas standardit EN 13348 ose Ekuivalent, për përdorim mjekësor të lëshuara nga prodhuesi.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë konformiteti për rekorderit e tubave të bakrit që janë sipas standardit ISO 2006:1981 ose Ekuivalent, për përdorim mjekësor të lëshuara nga prodhuesi.

Katalogët

Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë në formë elektronike www.app.gov.al katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për të gjitha materialet dhe pajisjet e sipërpërmendura, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi. Nëse nuk janë në gjuhën shqipe të jenë të përkthyer dhe të noterizuara si dëshmi e vërtetësisë dhe saktësisë së përkthimit. Në rastin e BOE ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje.

Bojërat dhe dyshemeja antibakteriale

Përsa i përket cilësive antibakteriale të bojërave dhe dyshemesë së brendshme (industriale me bikomponent, autoniveluese, rezistues ndaj shkrires, abrazionit dhe me përmbajtje antibakteriale, në finiturë mat) Operatori ekonomik ofertues, nëse nuk është prodhues, duhet të paraqesë raportet/certifikatat e testimit nga prodhuesi ose distributori, ku të vërtetohet se: produkti është antimikrobial (që vepron kundër mikroorganizmave) dhe ekologjik (EU ECO Label), ose ekuivalente të lëshuara nga institucione kombëtare dhe ndërkombëtare të akreditimit.

Shënim:

Në zbatim të rekomandimit të APP-së dhënë mbi draftin e DST, për rastet kur OE nuk është prodhues, AK do të pranojë edhe një vetëdeklarim nga OE ofertues që furnizuesi është konform standardeve të cilësisë, duke rezervuar të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit si dhe në rastin kur OE kualifikohet i pari, dhe të drejtën për ti kërkuar OE ofertues që të paraqesi certifikatën në fjalë.

Në zbatim të rekomandimit të APP-së dhënë mbi draftin e DST, karahas standardeve EN, AK do të pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, dhe nenin 79 të LPP, nenin 39, pika 8, dhe 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ku AK kërkon që të garantohet për cilësinë e materialeve, pjesëve ose linjave të gazrave mjeksor dhe pajisjeve që do të përdoren dhe vendosen në objekt, duke kërkuar të paraqes autorizim prodhuesi, marrëveshje bashkëpunimi, autorizim distributori dhe deklarata konformiteti.

NJËSIA E PROKURIMIT

Bledi Isufi

Arkadio Ramaj

Miranda Kocani